

INFORMATIVE PER PERPUNIMIN E TE DHENAVE PERSONALE

MBESHTETUR NE Rregulloren Evropiane GDPR nr. 2016/679 dhe në Dekretin Legjislativ 196/2003 “PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE”

Grandi Navi Veloci S.p.A., në cilësi të **kontrolluesit** të të dhënave personale, Ju informon mbi përdorimin e tyre dhe mbi të drejtat Tuaja, në mënyrë që të jepni, kur kërkohet, pëlqimin Tuaj me vullnet të lirë.

Të dhënat personale (të dorëzuara drejtpërdrejtë nga Ju, nga persona të tretë ose të ardhura, brënda kufijve ligjorë, nga numratorë publikë) mund të përpunohen për **qëllimet që vijojnë:**

1 – **ligjore:** për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji, nga një rregullore, nga legjislacioni i Bashkimit Evropian si edhe nga dispozitat e dhëna nga një Autoritet i legjitimuar me ligj apo nga Organet kompetente të mbikëqyrjes ose të kontrollit (në këtë rast dhënia e pëlqimit Tuaj nuk është e nevojshme sepse përpunimi i datave bëhet në respektim të këtyre detyrimeve/dispozitave);

2 – **kontraktuale** dhe, në përgjithësi, administrative- kontabël: domethënë për përmbushjen e detyrimeve të rrjedhuara nga kontratat në të cilat Ju jeni pjesë ose për plotësimin, para përfundimit të kontratës, të kërkesave Tuaja specifike, edhe nëpërmjet teknikave të komunikimit në distancë, ndër të cilat një call center (në këtë rast pëlqimi Juaj nuk është i nevojshëm, sepse përpunimi i datave është funksional për menaxhimin e marrëdhënies ose për plotësimin e kërkesave);

3 - **tregtare:** me pëlqimin Tuaj, për t’Ju ofruar informacione (edhe me anë të teknikave të komunikimit në distancë, të cilat mund të jenë, për shembull, korrespondencë me postë, thirrje telefonike edhe nëpërmjet sistemeve të thirrjeve të automatizuara, faks, e-mail, mesazhe SMS ose MMS ose të llojeve të tjera) mbi produktet, shërbimet ose iniciativat e Grandi Navi Veloci S.p.A. ose të palëve të treta, për promovime, për të kryer hulumtime të tregut dhe/ose për të vërtetuar cilësinë e produkteve ose të shërbimeve të ofruara (duke përfshirë thirrjet telefonike ose dërgimin e pyetësorëve), për optimizimin e ofertës (gjithashtu nëpërmjet analizave të fokusuara dhe të përzgjedhura).

Grandi Navi Veloci S.p.A. mund të përpunojë **të dhënat tuaja sensitive** vetëm sa është e nevojshme për veprime specifike të kërkuara nga Ju ose për menaxhimin e disa marrëdhënieve Tuaja me Grandi Navi Veloci S.p.A. dhe nën konformitet të autorizimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përpunimi i të dhënave Tuaja personale kryhet me dorë dhe në mënyrë automatike, me metoda të lidhura ngushtë me qëllimet e përmendura më lartë (ndoshta edhe nëpërmjet profilizimit ose krahasimit të të dhënave personale) dhe, në çdo rast, në mënyrë që të garantohet ruajtja, mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave Tuaja.

Në Grandi Navi Veloci S.p.A., mund të vijnë në **dijeni** mbi të dhënat Tuaja personale, personat e ngarkuar ose ata përgjegjës për përpunimin e tyre, punonjësit, bashkëpunëtorë të çdo lloji (p.sh: praktikantët) dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të ngarkuar për shërbime dhe zyra qendrore dhe të rrjetës së shitjeve, si edhe strukturat, e brendshme dhe të jashtme, të cilat kryejnë këshilla teknike, mbështetëse dhe kontrolluese në emër të Grandi Navi Veloci S.p.A.

Për realizimin e qëllimeve të sipërpërmendura Grandi Navi Veloci S.p.A. mund t'i **komunikojë** të dhënat tuaja subjekteve të caktuara, duke përfshirë dhe ato të huaja, përveç atyre të përcaktuara me ligj, për përpunimin dhe komunikimin përkatës.

Subjektët e përmendur më lartë do të përdorin të dhënat e marra në cilësit të “kontrolluesve” të pavarur përveç rastit kur janë përcaktuar nga Grandi Navi Veloci S.p.A. “përgjegjës” për përpunimin sipas kompetencave të tyre specifike.

Për më tepër, Grandi Navi Veloci S.p.A. Ju informon se të dhënat personale të përmbajtura në regjistrat e disa transaksioneve financiare (për shembull, në rastin e një transferimi, të dhënat e dërguesit) mund të transferohen, për qëllime të lidhura vetëm me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij, edhe autoriteteve publike të Shteteve Anëtare të BE-së si edhe vendeve të treta, ndër të cilët edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Grandi Navi Veloci S.p.A. **nuk i transferon palëve të treta** të dhënat Tuaja personale: të cilat, mund të shpërndahen dhe të përpunohen nga palët e treta vetëm nëse ato janë ngarkuar posaçërisht nga Grandi Navi Veloci S.p.A. dhe vetëm për qëllimet e pikës 3.

Ju mund të ushtroni **të drejtat** e përmendura në Nenin 7 të Dekretit Legjislativ 196/2003 dhe të Rregullores Evropiane 679/2016. Në veçanti, ju mund të dërgoni një kërkesë me shkrim, të shoqëruar nga një kopje të një dokumenti të vlefshëm identifikimi, **tek Grandi Navi Veloci S.p.A. – Tutela della Privacy (Mbrojtja e Privatësisë)**, Via Balleydier 7 - 16149 Genoa - GE, që të njihni të dhënat tuaja, prejardhjen dhe përdorimin e tyre, të merrni përditësimin, korrigjimin ose, në qoftë se jeni të interesuar, integrimin, si edhe, nëse përpunohen në kundërshtim me ligjin, të kërkonin anulimin ose bllokimin. Gjithashtu, Ju mund të kundërshtoni, për arsye të ligjshme, përpunimin e të dhënave. Kundërshtimi është gjithmonë i mundur dhe falas kur bëhet fjalë për reklama, oferta tregtare dhe për hulumtim të tregut.

Grandi Navi Veloci S.p.A.